



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË
“AEF BAILIFF SERVICE” SH.P.K

URDHËR

“për vënien e sekuestros konservative”

Drejtuar : **QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT**
Për dijeni : Shoqëria “COOP Studenti” Sh.p.k me NIPT L52202041D
Për dijeni : Shoqëria “Cosmesi Center” sh.p.k me NIPT J92228501W



Pranë Zyrës së Përmbarrimit Gjyqësor Privat të Shoqërisë “AEF BAILIFF SERVICE” sh.p.k. me kërkesë të palës kreditore është regjistruar çështja përmbarrimore me palë :

Debitor : Shoqëria “COOP Studenti” Sh.p.k me NIPT L52202041D
Kreditorit : Shoqëria “Cosmesi Center” sh.p.k me NIPT J92228501W
Objekti : Përmbushje detyrimi

Unë Përmbarruesi Gjyqësor privat Resul ALUSHANI pasi shqyrtova materialin e dosjes përmbarrimore,

KONSTATOVA :

Për titullin ekzekutiv Faturë Tatimore Shitje me Nr. serie 25348203 Datë 16.10.2015 dhe Faturë Tatimore Shitje me Nr. serie 28526307, date 17.12.2015 është lëshuar Urdhri i Ekzekutimit Nr. 455/U datë 30.01.2017 i Gjykatës së Rrethit Tiranë me objekt:

“Lëshimin e urdhrorit të ekzekutimit për titullin ekzekutiv Faturë Tatimore Shitje me Nr. serie 25348203 Datë 16.10.2015 dhe Faturë Tatimore Shitje me Nr. serie 28526307, date 17.12.2015”.

Pasi kanë kaluar afatet e parashikuara ligjore dhe debitori nuk e ka përmbushur detyrimin, në bazë të nenit 519 të K.Pr.Civile nga ana e jonë është marrë vendimi i kalimit në ekzekutim të detyrueshëm duke vendosur masën e sekuestros konservative në kuotat që zotëron debitori Shoqëria “COOP Studenti” Sh.p.k me NIPT L52202041D me qëllim mostjetërsimin dhe/ose disponimin e tyre si dhe mos kryerjen e asnjë veprimi tjetër i cili mund të ndryshojë të dhënat e regjistrorit tregtar

Per kete arsye si dhe në bazë të nenit 527 e në vijim të K.Pr.Civile,

URDHEROJ :

1. Qendra Kombëtare e Biznesit të vendosë masën e sekuestros konservative në kuotat që zotëron debitori Shoqëria “COOP Studenti” Sh.p.k me NIPT L52202041D me qëllim mostjetërsimin dhe/ose disponimin e tyre si dhe mos kryerjen e asnjë veprimi tjetër i cili mund të ndryshojë të dhënat e regjistrorit tregtar.
2. Dokumentacioni do të qëndrojë i bllokuar deri në një urdhër të dytë nga ana jonë.
3. Për veprimin apo mosveprimin tuaj, duhet të na vini në dijeni shkresërisht brënda afatit ligjor. Për personat që bëhen pengesë në zbatimin e këtij urdhëri do të merren masat e parashikuara në nenin 606 e në vijim të K.Pr.Civile, si dhe në rast se ka vënd do të kërkohet ndjekje penale në bazë të dispozitave të Kodit Penal.
4. Ky urdhër mbahet ne 4 kopje e ju njoftohet palëve të cilat në bazë të nenit 610 të K.Pr.C kanë të drejtën e ankimit në gjykatën e rrethit gjyqësor brënda 5 ditëve nga marja dijeni.

“AEF BAILIFF SERVICE” Sh.p.k
PËRMBARUESI GJYQËSOR
RESUL ALUSHANI

